REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 60/17, 67/17
Datë/Datum. 21.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW

PSH. Nr. 60/17
67/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga Kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, për prokurimin publik në Kosovë, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin nr.04/L-237, dhe me ligjin nr.05/L-068 , në përbërje prej: z. Ekrem Salihu - Kryetar, z. Tefik Sylejmani – Referues, z. Nuhi Paqarizi - anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE. "Trio Med" – Prishtinë , përfaqësuar nga z. Bajram Sherifi dhe ankesës së parashtruar nga OE "ICN BM" - Prishtinë , përfaqësuar nga z. Bejtush Gashi, kundër autoritetit kontraktues-Ministria e Shëndetësisë,përfaqësuar nga z.Berat Marmullaku, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me barna dhe material shpenzues medicinal nga lista esenciale"**, LOT 9, 22, 23 dhe 24 me numër të prokurimit: 206/16/103/111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Shëndetësisë**, më: 07.04.2017, mori këtë :

V E N D I M

I.REFUZOHET, si e pa bazuar ankesa e OE. **"Trio Med"** - Prishtinë, lidhur me procedurën e prokurimit me titull: **"Furnizim me barna dhe material shpenzues medicinal nga lista esenciale"**, Lot 22, 23 dhe 24 me numër të prokurimit: 206/16/103/111, ndërsa mbetet në fuqi vendimi i autoritetit kontraktues përkitazi me lotet 22 , 23 dhe 24.

II.APROVOHET, pjesërisht ankesa e OE. "ICN BM" - Prishtinë, lidhur me procedurën e prokurimit me titull: **"Furnizim me barna dhe material shpenzues medicinal nga lista esenciale"**, Lot 9 me numër të prokurimit: 206/16/103/111 dhe lënda përkitazi me Lot-9, kthehet ne Ri-vlerësim.

III. Meqenëse pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues "ICN BM" - Prishtinë janë pjesërisht të qëndrueshme, konform nenit 118 të LPP-së, i kthehet sigurimi i ankesës, ndërsa OE. ankues "Trio Med", i bëhet konfiskimi i mjeteve për sigurim të ankesës, konform nenit 118 të LPP-së.

A R S Y E T I M

Autoriteti kontraktues-Ministria e Shëndetësisë më dt.24.10.2016 ka bërë publikimin e njoftimit për kontratë : **"Furnizim me barna dhe material shpenzues medicinal nga lista esenciale"**, LOT 9, 22, 23 dhe 24 me numër të prokurimit: 206/16/103/111 , lloji i kontratës së publikuar-furnizim,vlerë e madhe , afati i fundit për dorëzim të ofertave ka qenë dt.29.11.2016, kriter për dhënje të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjëshëm-çmimi më i ulët.
Autoriteti kontraktues më dt.15.02.2017 bënë njftimin në Krpp për dhënje të kontratës për lot-22,23 dhe 24, kurse më dt.20.02.2017 bënë njoftimin për anulim të lot-9.

Operatori ekonomik "Trio Med" - Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP më 07.03.2017, me nr. të protokollit, 67/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të OE. "Made Kos" - Prishtinë, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së.

Operatori ekonomik "ICN BM" - Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP më 28.02.2017, me nr. të protokollit, 60/17, kundër njoftimit për anulim te Lot 9, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së nr. 04/L-042, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar procedurën e zhvilluar lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues në raportin e datës: 27.03.2017, ka sqaruar se AK-ja, lidhur me Lot 9 i ka respektuar dispozitat e LPP-së dhe se pretendimi ankimor i parashtruar në ankesë është i paqëndrueshëm. Ndërsa ne lidhje me ankesën e OE ankues "Trio Med", eksperti shqyrtues, ka sqaruar se ankesa është pjesërisht e bazuar. Andaj, duke u bazuar në sqarimet e dhëna në raport të ekspertizës i ka propozuar panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues "ICN BM" të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa ankesa e OE ankues "Trio Med" te aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe njëherit i ka propozuar panelit shqyrtues që Lot 22, 23 dhe 24 te Ri-vlerësohen. Ndërsa ne lidhje me Lot 9 te aprovohet vendimi i AK-së për anulim te aktivitetit te prokurimit.
OE. ankues "ICN BM" – Prishtinë, përmes parashtresës, ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues të dhënë në raportin e datës 27.03.2017.

OE ankues "Trio Med" – Prishtinë, në parashtresën, ka deklaruar se pajtohet me mendimin dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues të dhënë në raportin e datës 27.03.2017.

AK-ja, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me raportin dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues, për këtë aktivitet të prokurimit.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, më 06.04.2017, ishin prezent anëtarët e Panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesit e autorizuar te OE-ve ankues, përfaqësuesi i OE. te rekomanduar për kontratë, përfaqësuesja e AK-se. Në seancë u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, përgjigjja e AK-së mbi raportin e ekspertizës si dhe parashtresa e OE ankues lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.
Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesi i OE ankues "ICN BM" z.Gashi deklaroj:" Oferta jonë është për një artikull me emër komercial" Kongullex", preparat i regjistruar pranë Agjencionit te barnave, ështe prodhim Austriak. Çmimin që ne kemi ofruar ka qenë e ofruar nga prodhuesi të cilin e ka kalkuluar firma sipas mendimit të saj, dhe mendojmë se oferta jonë sipas kritereve të parapra me dokument standard ka qenë kriteri çmimi më i ulët.
Sa i përket deklarimit të AK-se, për çmimet e tregut, mendojmë se për këtë artikull kemi ofruar çmim real pasi është prodhim cilësor, dhe qëndrojmë pranë ofertës tonë.
AK-ja, ndoshta ka bërë krahasim me prodhime të ndonjë prodhuesi tjetër, andaj edhe mund të

dalloj çmimi mes prodhuesve.I propozojmë panelit të aprovoj ankesën tonë dhe lënda të kthehet në |Rivlerësim".

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të OE ankues "Triomed" z.Sherifi i cili deklaroj:" Edhe më tutje qëndrojmë pranë shkresës së dërguar lidhur me konstatimet e ekspertit shqyrtues. Tri pretendimet për cilat jemi eliminuar nga AK-ja. Si pikë kryesore ka qenë se nuk kemi plotësuar certifikatën e prodhuesit" ISO", kjo nuk qëndron pasi në dosje të lëndës ekziston certifikata e cila është dorëzuar në lëndë, si dhe më vonë pas interesimit nga AK-ja vet prodhuesi i ka dërguar email me të cilën i ka dhënë shpjegimet e duhura, pretendimeve të AK-së. Emaili gjendet pranë AK-së, dhe një kopje të tij i ofroj panelit shqyrtues. Janë dy certifikata, certifikata e mëhershme me validitet deri në vitin 2017 dhe certifikata e re me validitet deri në vitin 2019.

E para ka qenë certifikata që ka qenë e ofruar në dosje të tenderit, ndërsa certifikata dytë është dorëzuar me rastin e kërkesës për rishqyrtim pranë AK-së. I ofroj panelit si provë kopje të dy certifikatave të lartcekura.

I propozoj panelit shqyrtues që ankesën ta aprovoj si të bazuar dhe aktivitet i prokurimit të kthehet në Rivlerësim. Ne si ofertues kemi qenë ofertuesi më i lirë se OE që është rekomanduar për kontratë në vlerë 6640€, andaj shpresojmë se paneli do ketë parasysh interesin publik me rastin e marrjes së vendimit".

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të OE "MadeKos" z.Buzuku i cili deklaroj:" Njoftoj panelin se pas qasjes në dokumente zyrtare tek AK-ja, për këte tender, në dokumentet e OE ankues "Triomed" kemi hasur në certfikatën ISO me numër Q2N 14 07 81232 003. Ku kemi vërtetuar te certifikuesi TUV në Gjermani, dhe kjo certikfattë në dosje të tenderit me afat të skadencës 2017.08.09, është pastër falsifikuar, pra bëhet fjalë për afatin e kësaj certifikate e cila iu ka zgjat afati në mënyrë të jashtëligjshme është ndërhyrje, si dëshmi ju paraqes panelit këtë certifikatë.

Në email të TUV nga Gjermania kemi pranuar deklaratë se kjo certifikatë me këtë numër ka skaduar në vitin 2015.

Po ashtu me rregulla të TUV, asnjë certifikatë nuk është valide e cila pranë vulës së TUV ka ndonjë vul apo diqka tjetër. Kërkojmë nga paneli shqyrtues të refuzoj ankesën e OE ankues dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK për lot.22, 23, 24".

Në vazhdim të seancës fjala iu dha përfaqësuesit të AK –MSH z.Marmullaku i cili deklaroj: Sa i përket ankesës së OE "ICN BM" nga Prishtina dhe arsyeve të eliminimit të tij për lot.9, ne qëndrojmë pranë vendimit të AK-se, për anulim të këtij loti, për shkak të çmimit që është konsideruar si i lartë në krahasim me çmimin e tregut.

Si komision i vlerësimit lidhur me barna kur vlerësohen barnat, i konsultojmë profesionalisht në mënyrë zyrtare njësinë e kërkesës - departamenti i farmacisë në MSH. Edhe në lot.9 të këtij tenderi ne kemi shkruar email zyrtar drejtorit të departamentit të farmacisë ku kemi kërkuar sqarime profesionale me çimin e këtij Loti.

Na është kthyer përgjigje me shkrim me datë 03.02.2017 në të cilën thuhet "lidhur me kërkesën tuaj ju njoftojmë se duke u bazuar në të dhënat e SMSF, çmimi nga kontrata e kaluar për produktin Sodium Valproat, tabletë 500 miligram, ka qenë 0.115€".

Ndërkohë oferta e" ICN BM" për këtë lot ka qenë 0.99€. Si komision vlerësues ne nuk kemi pas mundësi të veprimit ndryshe përveç se të anulohet për shkak të çmimit të lart.

Vlen të ceket se aktualisht në bazë të Udhëzimit Administrativ UA 02/2015 të AKPM-së, kërkohen - është kusht që barnat të jen të regjistruara për shitje në Kosovë. Në bazë të këtij kushti kemi vazhdimisht situata që barnat që janë të regjistruara nga veç një prodhues nuk kanë konkurrencë dhe kemi çmime më të larta.

Në pyetje të kryetarit të panelit se sa oferta gjithsej kanë qenë për lot.9, në përgjigje z.Marmullaku u përgjigj: Për këtë lot kanë që qenë dy OE, ku njëri ka pas çmim edhe më të lart se OE ankues "ICN BM".

Kryetari i panelit pyeti përfaqësuesin e AK-se, se a e ka tejkaluar buxhetin e AK për këtë lot, OE ankues.

Në përgjigje z.Marmullaku deklaroj: Nuk kam njohuri apo prova me vete në këtë moment.

Anëtari i panelit pyeti përfaqësuesin e AK-se, se a ka ndonjë prodhues tjetër të regjistruar për këtë produkt.

Në përgjigje z.Marmullaku deklaroj: me sa kam unë njohuri është vetëm një prodhues i regjistruar pranë AKPM për këtë produkt.

Lidhur me ekspertizën e dhënë për lotet 22, 23, 24, ankesës së OE. "Triomed", ne si AK nuk pajtohemi me ekspertizën që kjo të rivlerësohet, por kërkojmë të mbetet në fuqi vendimi i ynë për dhënie të kontratës. Lidhur me lotet 22, 23, 24, janë disa aspekte kontestuese që janë evidentuar qysh në fillimi t vlerësimit të ofertës. Në ofertën e OE "TRIOMED" janë dy certifikata, certifikata "CE" dhe certifikata" ISO".

Në këto dy certifikata janë të dhënat e njëjta, numrin raportues të lëndës që është lëshuar certifikata, raport number.SH147 35 03, valide prej 2014-12-05, valid deri 2017-08-19.

Për neve kjo ka qenë e paarsyeshme e pakuptueshme se si mundet dy certifikata të ndryshme të kenë të dhënat e njëjta.

Njëkohësisht ne certifikatën" ISO" figuron edhe vula kineze krahas vulës së" TUV"-it, dhe kjo është e pakuptimtë.
Në përgjigjen që kemi marr nga "TUV", thotë se certifikata e prezantuar me numrin- Q2N 14 07 81232 003, ka qenë valide deri në vitin 2015. Ndërsa në certifikatën ekzistuese në tender është viti 2017. "TUV" ka konfirmuar se certifikata është përtërirë me certifikatë tjetër me numër përfundimtar 005. Sipas verifikimit këtë javë, në linkun e "TUV", figuron se tanimë është valide me numër përfundimtar 006.
Lidhur me konstatime ekspertit ku thotë se AK i ka pas të dhënat e prodhuesit, adresën dhe mundësit të verifikoj, si dëshmi ju njoftoj se edhe në fazën e vlerësimit komisioni ka bërë verifikim sipas të dhënave të këtij prodhuesi në Kinë, dhe si dëshmi është kjo hartë që tregon për një zonë banimi. Kjo ka qenë arsye që nuk kemi pas nevojë të verifikojmë më tej se nuk ka fabrikë. Po ashtu autorizimi i ofruar nga OE. nuk ka të dhënat dhe nuk është kompatibil me kërkesën tonë, nuk ka ve b faqe, nuk ka titullin e prodhuesit, etj. Para seancës i kemi shkruar prapë TUV, mirëpo nuk kemi marr ende përgjigje.
I rekomandojmë panelit që të refuzoj ankesat e OE-ve dhe të vërtetoj vendimin e AK-së".

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues z.Basha i cili deklaroj: Lidhur me ofertën e OE "ICN BM" i eliminuar për shkak çmimit të ofruar, AK ka bërë një hulumtim të tregut ku në shkresa të lëndës ka ofruar edhe disa fatura tatimore të barnatoreve, ku çmimi në bazë të atyre faturave është shumë më u i ulët se çmimi i ofruar në ofertën e OE "ICN BM", andaj bazuar në nenin 61.4 vlerësimi çmimeve është e drejtë e AK-së.

Lidhur me ofertën e "TrioMed", certifikata "ISO" e dorëzuar në ofertën e tij të gjitha të dhënat i përmban sipas kërkesës së dosjes, mirëpo AK-ja, ka pas dyshime lidhur me këtë certifikatë dhe e ka verifikuar tek certifikuesi, i cili në këtë rast nuk ka dhënë përgjigje përfundimtare ku ka deklaruar se certifikata me numër 003 është zëvendësuar me certifikatën me numër 005.
Bazuar në këto sqarime vlerësoj se nuk është saktësuar data e saktë e skadimit të kësaj certifikate, andaj edhe propozimi për rivlerësim ka qenë të sqarohen më saktë certifikatat e OE "Triomed".

Anëtari i panelit z.Sylejmani pyeti përfaqësuesin e AK- se kur i skadon certfikatës 003, në përgjigje z.Marmullaku deklaroj: kësaj certifikate i ka skaduar afati në vitin 2015.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues të AK-së, shqyrtimit të pikës pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve,

analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues të cekur në ekspertizë, parashtresës së OE. ankues, parashtresës së AK-së, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton dhe vlerëson se është i qëndrueshëm pretendimi i OE. ankues "ICN BM", lidhur me çmimin e produktit të ofruar për Lot 9, për faktin se nuk është i mjaftueshem hulumtimi i bërë nga AK-ja, pasi qe është e nevojshme të bëhet hulumtimi i tregut nga prodhuesit evropian ne lidhje me çmimin e produktit të njejtë apo ekuivalent , sepse paneli shqyrtues pati parasysh faktin se i vetmi produkt i regjistruar ne Agjensionin për Produkte Medcinale është produkti i ofruar nga OE. ankues "ICN BM" dhe se paneli shqyrtues nuk pati prova se ankuesi ka bërë tejkalim të bugjetit të parapar nga ana e autoritetit kontraktues lidhur me këtë lot.

Paneli shqyrtues, lidhur me ankesen e OE. ankues "Trio Med", konstaton dhe vlereson se është i paqendrueshëm pretendimi i OE. ankues në lidhje me certifikaten "ISO" me nr. Q2N 14 07 81232 003, per faktin se me daten: 07.04.2017 nga certifikuesi "TUV", është konfirmuar përmes email-it se kjo certifikat është jo valide prej dates: 19.08.2015, që do të thotë se në momentin e ofertimit kjo certifkat ka qene e skaduar.

Paneli shqyrtues më dt.07.04.2017 ka pranuar parashtresë me shkrim nga ana e OE."Trio Med" për tërheqje të ankesës lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë, por të njejtën nuk e ka shqyrtuar pasi që e njejta është deponuar pas mbajtjes së shqyrtimit dhe jashtë afatit ligjor.

Paneli shqyrtues, ne vazhdim vlereson se arsyetimet tjera ne lidhje me oferten e OE ankues nga ana e AK-se, jane te paqëndrueshme per faktin se seancen degjimore duke u bazuar ne sqarimet e dhena edhe nga eksperti shqyrtues u vertetua fakti se keto dokumente i ka dorezuar ne oferten e tij OE. ankues "Trio Med".

Prandaj Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, si dhe duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :
Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur
nuk mund të ushtron ankesë,
por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh,
pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë
kërkesë-padi në Gjykatën Themelore - Prishtinë
Departamenti për Çështje Administrative.

Kryesues i Panelit Shqyrtues
Ekrem Salihu

REPUBLIKA E KOSOVËS
PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TRIO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Vendimi t'i dorëzohet:
1. 1x1 Autoritetit kontraktues.
2. 1x1 OE.ankues,
3. 1x1 Arkivës së OSHP-së